



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 892/2 prot.

Tiranë, më 23 . 06 . 2022

**V E N D I M**

**Nr. 127 , datë 23 . 06 . 2022**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, është paraqitur ankesa nr. 97 Regj., datë 13.06.2022, nga shtetasi B. Z, kundër Zyrës Përmbaremore Lezhë, me pretendim diskriminimin për shkak të “gjinisë”, “bindjes fetare” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, subjekti ankues, B. Z, informon Komisionerin lidhur me problematikën e tij.

Në vitin 2009 ka lidhur martesë me shtetasen F. Xh. dhe nga kjo martesë në vitin 2010 ka ardhur në jetë fëmija i tyre A. Z. Në vitin 2013 ankuesi është divorcuar ligjërisht me ish-bashkëshorten e tij dhe lidhur me këtë fakt, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin nr. 416, datë 29.07.2013 ka disponuar, ndër të tjera:

- *“Zgjidhjen e martesës midis paditëses të kundërpaditur F. Xh. dhe të paditurit kundërpaditës B. Z.*

<sup>1</sup> Në vijim referuar me akronimin KMD ose si Komisioneri.

- *Ushtrimin e përgjegjësisë prindërore mbi fëmijën A. Z. nga paditësja e kundërpaditur F. Xh.*
- *Të drejtën e të paditurit kundërpaditës B. Z të takohet me fëmijën e tij A. Z., javën e parë dhe të tretë të çdo muaji kalendarik nga ora 09:00 deri në orën 17:00 të ditës së shtunë, si dhe për pushime verore në periudhën kohore nga data 1 gusht deri në datën 31 gusht, të çdo viti kalendarik, si dhe për pushime dimërore në periudhën kohore nga data 24 dhjetor deri më datë 30 dhjetor të çdo viti kalendarik.....”.*

Kundër këtij vendimi ka bërë ankimim subjekti ankues, dhe Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 3912, datë 05.12.2014 ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 416, datë 29.07.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë”.*

Me kërkesën e subjektit ankues, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin nr. 101, datë 30.03.2015, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin civil me nr. 416, datë 29.07.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Në parashtrimet e tij, subjekti ankues shprehet se:

*“Të gjitha pjesët urdhëruese të këtij vendimi janë zbatuar siç urdhërohet në të, përveç pjesës që ka të bëjë me të drejtën e takimit me fëmijën tim, e cila nuk është zbatuar për shkak të pengesave të ish-bashkëshortes F. Xh. Kam patur gjithmonë probleme në lidhje me takimet me fëmijën tim, për shkak të vështirësisë e pengesave që nxirrte kjo shtetase duke nxjerrë pengesa për t’i mohuar fëmijës tim atashimin me babain biologjik. Sa herë që takoheshim tek Zyra e Përmbarrimit Lezhë, ish-bashkëshortja ime e agravonte situatën duke tensionuar gjendjen në takimin me fëmijën tim me qëllim e keqdashje, për t’i krijuar fëmijës atmosferë negative në momentin e takimit, pasi ajo shpërthente në sharje e ofendime ndaj meje, në sy të fëmijës dhe të përmbarrueses.*

*Për këto pengesa jam ankuar disa herë tek Zyra e Përmbarrimit si dhe Policia e Lezhës. Përmbarrueset favorizonin ish-bashkëshorten time për shkak të njohjeve që kishin me të dhe nuk zbatonin qëllimisht vendimin e Gjykatës, duke më diskriminuar për dallime krahinore e fetare, të cilat i kam denoncuar edhe më parë në Policinë e Lezhës”.*

Subjekti ankues vijon në parashtrimet e sjella pranë KMD-së me shpjegimin e situatës problematike e konfliktuale mes tij dhe ish-bashkëshortes.

Ai ka pretenduar se ish-bashkëshortja e ka braktisur fëmijën disa herë, duke u larguar jashtë shtetit, fakt të cilin e ka denoncuar në organet kompetente. Po ashtu, ish-bashkëshortja, sipas pretendimeve të ankuesit ka tentuar të manipulojë dokumente e fakte për të dërguar jashtë shtetit dhe fëmijën e tij të mitur, duke vënë në rrezik kështu edhe jetën e tij.

Lidhur me këtë fakt, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë ka regjistruar procedimin penal nr. 391, për veprat penale të “Dhunës në familje” dhe “Braktisja e fëmijës së mitur” ndaj shtetasës F. Xh., e cila e ka dërguar për kompetencë pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Ankuesi gjithashtu ka pretenduar se është kërcënuar, fyer e dhunuar nga ish-bashkëshortja e tij dhe për këtë arsye ka kërkuar lëshimin e urdhrit të mbrojtjes.

Në dispozitivin e Vendimit me nr. 53-2022-1079, datë 04.05.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, është vendosur:

- *“Lëshimi i urdhrit të mbrojtjes, duke vendosur këto masa:*
- *Urdhërimin e të paditurës F. Xh., të mos kryejë veprë të dhunës në familje ndaj paditësit B. Z.*
- *Urdhërimin e të paditurës F. Xh., të mos çënojë, kërcënojë, ngacmojë, kontaktojë ose komunikojë drejtpërdrejtë ose tërthorazi me paditësin B. Z.*
- *Urdhërimin e të paditurës F. Xh., të mos i afrohet paditësit, shtëpisë ku jeton paditësi, vendit të punës së paditësit apo vendeve që frekuenton paditësi në një distancë prej 100 m.*
- *Kohëzgjatja e masë është deri me datën 04.05.2023, me të drejtë ripërtëritje.*
- *Shkelja e këtij vendimi përbën veprë penale, në kuptim të nenit 321 të Kodit Penal.*
- *Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet menjëherë.*
- *.....”.*

Subjekti ankues, në vijim të pretendimeve të tij shprehet se: *“Nuk kam qenë dakord me veprimet e përmbaueses, pasi ka qenë e njëanshme duke favorizuar palën tjetër gjatë ekzekutimit, por nuk kisha zgjedhje tjetër për të takuar fëmijën tim përveçse në zyrën e saj për 10 minuta.*

*....theksoj se janë konsumuar elementët e veprave penale si nga ana e palës debitore, ashtu edhe nga ana e përmbaueses me shpërdorim detyre e veprime arbitrare kundrejt meje.*

*I jam drejtuar organeve të shtetit shqiptar në rrugë ligjore, lidhur me pasojat që më kanë ardhur nga pengesat e ish-bashkëshortes në bashkëpunim me personelin e Zyrës Përmbaimore Lezhë, duke më penalizuar për inate personale, me bazë krahinore e fetare. Nga ana e përmbaueses nuk është marrë asnjë masë me sanksione ligjore kundrejt ish-bashkëshortes. Nga ana e përmbaueses nuk është marrë asnjë masë për mbrojtjen time kundrejt kërcënimeve e fyerjeve të bëra në praninë e saj nga ana e F. Xh. Madje, përmbauesja L. Ç. ka dërguar edhe informacion të pavërtetë e të rremë në Drejtorinë e Përgjithshme dhe institucione të tjera.*

*....unë ndjehem i rrezikuar nga personeli i Zyrës së Përmbaimit Lezhë për inatet personale të përmbaueses së kësaj Zyre, të cilën e kam denoncuar se është pengesë ndaj meje në vitin e*

*kaluar, dhe ajo më ka diskriminuar me bazë gjinore, krahinore e fetare, duke më thënë se nuk më intereson kush je ti, unë jam katolike e ti mysliman. Ndërsa me datë 19.03.2021 në Zyrën e Përmbarrimit, drejtuesja e Zyrës në bashkëpunim me kolegët e saj më kanë grabitur me dhunë telefonin duke më fshirë sms e bisedat e mëparshme ku kishim komunikuar me të nga frika se mos i publikoja sms. Këtë ngjarje e kam denoncuar në Policinë e Lezhës, por nga ndërhyrja e saj, duke dërguar informacion të rremë e të pavërtetë në organet përkatëse, ajo ka manipuluar ngjarjen dhe më ka kërcënuar të mos publikoj sms. Për këto arsye, kërkoj nga Drejtoria e Antikorrupsionit me ekspertë nga Tirana, që të hetohen me metoda speciale përmbarruesit e Zyrës së Përmbarrimit Lezhë, përmes verifikimit të sms, bisedave telefonike, komunikimi në internet për vitin 2021-2021, si dhe të vihen para përgjegjësive ligjore personat që kanë penguar zbatimin e dy vendimeve gjyqësore”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, shprehimisht: “*Të konstatohet diskriminimi, vënia para përgjegjësive ligjore për punonjësit e Zyrës Përmbarrimore Lezhë, të cilët nuk kanë zbatuar vendimet e gjykatës, si dhe të hetohen me metoda speciale nga Drejtoria e Antikorrupsionit punonjëset L.Ç dhe S. Gj”.*

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata

ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirisë dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

*Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:*

Subjekti ankues, ka ngritur pretendime ndaj dy përmbaruesve të Zyrës Përmbarimore Lezhë, lidhur me veprimet e mosveprimet e tyre, përsa i takon:

- Moszbatimit korrekt të vendimit nr. 416, datë 29.07.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, lidhur me oraret e takimit me fëmijën e tij të mitur A. Z. si dhe mosmenaxhimit të situatës me ish-bashkëshorten e tij përsa i takon konflikteve të vazhdueshme mes tyre (*përfshirë edhe urdhrin e mbrojtjes të ankuesit nga F. Xh.*);
- Ndërhyrjes së padrejtë dhe njëanshmërisë së treguar nga përmbarueset e kësaj Zyre, në favor të ish-bashkëshortes, lidhur me zbatimin e vendimit sipërcituar, të Gjykatës;
- Manipulimit të informacionit e dërgimit të materialeve të pavërteta e të rreme në organet e tjera shtetërore lidhur me ankesat e denoncimet e tij kundrejt Zyrës Përmbarimore Lezhë;
- Kërcënimeve të bëra ndaj tij nga punonjësit e kësaj Zyre dhe faktit që ndihet i rrezikuar prej tyre, pasi mund të veprojnë në dëm të tij duke shfrytëzuar detyrën shtetërore e pozicionin që kanë.

Subjekti ankues ka kërkuar që veprimet e tyre të hetohen përmes hetimit special të sms, tabulateve telefonike, rrjeteve të komunikimit nëpërmejt internetit, nga ana e Drejtorisë së Antikorrupsionit pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Ligji nr. 8730, datë 18.01.2001 “*Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor*”, i ndryshuar, në nenin 2<sup>2</sup>, të tij, ka përcaktuar se:

*“1. Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.*

---

<sup>2</sup> *Objekti i veprimtarisë*

2. *Shërbimi i Përmbarrimit Gjyqësor i ushtron funksionet nëpërmjet përmbarruesve gjyqësorë*”.

Pika 1, e nenit 5<sup>3</sup>, të këtij Ligji përcakton se:

*“Përmbarruesi gjyqësor është personi i ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile”.*

Neni 35<sup>4</sup>, pika 1, shkronja dh) e ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 *“Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor”*, të ndryshuar, ngarkon me përgjegjësi, me shkarkim nga detyra, përmbarruesin gjyqësor, duke përcaktuar se:

*“1.Përmbarruesi gjyqësor shkarkohet nga detyra në këto raste:*

*a) kur dënohet për kryerjen e një vepre penale;*

*b) kur kryen shkelje të rënda të disiplinës në punë;*

*c) kur kryen në mënyrë të përsëritur thyerje të disiplinës dhe nuk i është hequr masa e dhënë më parë;*

*ç) kur provohet se ka përdorur funksionin e tij në shërbim të interesave vetjake ose të personave me të cilët ka lidhje familjare;*

*d) kur provohet se me veprimet ose mosveprimet e tij ka krijuar favore të padrejta për persona të tjerë;*

*dh) kur nuk përmbush veprimet përmbarrimore të parashikuara në ligj;*

*e) kur është vlerësuar “i paaftë” në përputhje me pikën 2 të nenit 14 të këtij ligji”.*

Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 *“Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar (në vijim, K.Pr.C), në nenin 510 të tij ka përcaktuar se, ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv, dhe se, janë tituj ekzekutivë, sipas përcaktimeve të këtij neni:

*“a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm;*

*b) vendimet penale të formës së prerë në pjesën që bëjnë fjalë për të drejta pasurore;*

*c) vendimet e gjykatave e të arbitrazheve të shteteve të huaja që u është dhënë fuqi sipas dispozitave përkatëse të këtij Kodi;*

*ç) vendimet e një gjykate arbitrazhi në Republikën e Shqipërisë;*

*d) aktet noteriale që përmbajnë detyrim në të holla, si dhe aktet për dhënien e kredive bankare ose aktet për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare;*

*dh) kambialet, çequet e letrat me urdhër që barazohen me ato;*

---

<sup>3</sup> Përmbarruesi gjyqësor

<sup>4</sup> Shkarkimi

*e) aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përmbarimit për ekzekutimin e tyre”.*

Në nenin 515 dhe 524, të tij, K.Pr.C, ka përcaktuar se:

*“Urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga shërbimi përmbarimor gjyqësor, shtetëror ose privat, me anë të përmbaruesit gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit...”.*

Bazuar në sa më lart, Komisioneri vëren se, Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor, ushtron veprimtarinë e tij, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 *“Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor”*, të ndryshuar, dhe ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile dhe se, personi i ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile është pikërisht përmbaruesi gjyqësor.

Pra, në këtë kontekst, në rastin në fjalë, Komisioneri vlerëson se, nëse përmbaruesi gjyqësor i Zyrës Përmbarimore Lezhë, *(si pjesë e Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Shtetërorë)*, nuk ka zbatuar Urdhrin e Ekzekutimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë *(në përmbushje të Vendimit nr. nr. 416, datë 29.07.2013)*, ai nuk ka përmbushur detyrimin e tij në zbatim të detyrave funksionale, konform përcaktimeve të ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 *“Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor”*, të ndryshuar.

Në këtë kontekst, Komisioneri, vëren se, pretendimi i subjektit ankues, për moszbatim apo keqzbatim të vendimit respektiv të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, lidhur me oraret dhe menaxhimin e takimit të tij me fëmijën e mitur, mund të zgjidhet vetëm nëpërmjet kontrollit gjyqësor, ankimimit përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, sipas parashikimeve ligjore të K.Pr.C.

Neni 610<sup>5</sup> i K.Pr.C., ka parashikuar shprehimisht, se, kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, të kryera në kundërshtim me procedurat e parashikuara nga ky Kod dhe kundër refuzimit të përmbaruesit gjyqësor për të kryer një veprim që ia ngarkon ligji, palët mund të bëjnë ankim në gjykatën që ekzekuton vendimin.

Neni 321<sup>6</sup>, i Kodit Penal, përcakton se: *“Kryerja e veprimeve në kundërshtim me vendimin e gjykatës në lidhje me detyrimet e lindura nga dënimet plotësuese të dhëna prej saj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet. Kryerja e veprimeve në kundërshtim me vendimin e gjykatës, në lidhje me detyrat e lindura nga urdhrat e mbrojtjes të dhëna prej saj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim gjer në dy vjet”.*

---

<sup>5</sup> *“Kundërshtimi i veprimeve të përmbaruesit gjyqësor”.*

<sup>6</sup> *“Veprime në kundërshtim me vendimin e Gjykatës”.*

Për rrjedhojë, trajtimi i kësaj kërkesë të ankuesit, nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Në nenin 33, pika 4/b, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b)..... është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.”

Lidhur me pretendimin e ankuesit se punonjësit e Zyrës Përmbartimore Lezhë, kanë shpërdoruar detyrën përmes njëanshmërisë së manifestuar, manipulimit të dokumentacionit, përpilimit e hartimit të akteve procedurale të rreme e të pavërteta, si dhe sajimeve kundrejt tij në organe të caktuara shtetërore, Komisioneri vëren se, hetimi i tyre nuk bën pjesë në kompetencën e KMD-së.

Pra, për sa më sipër është organi i Prokurorisë, organi kompetent që ushtron ndjekjen penale.<sup>7</sup>

Neni 1, dhe 1/b, i Kodit Penal, përcakton se: *“Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre. Veprat penale ndahen në krime dhe në kundravajtje penale. Legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë ka për detyrë të mbrojë pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën, mjedisin, bashkëjetesën dhe mirëkuptimin e shqiptarëve me pakicat kombëtare, si dhe bashkëjetesën fetare nga veprat penale, si dhe parandalimin e tyre”*.

Neni 120<sup>8</sup>, i Kodit Penal, përcakton se: *“Përhapja e qëllimshme e thënieve, si dhe çdo informacion tjetër, duke e ditur se janë të rreme, që cenojnë nderin dhe dinjitetin e personit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion e pesëqind mijë lekë. Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë”*.

Neni 186<sup>9</sup>, i Kodit Penal, përcakton se: *“Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet.*

*Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunimi ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.*

*Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, dënohet me burgim nga një vit deri në shtatë vjet”*.

<sup>7</sup> Neni 148, i Kushtetutës së Shqipërisë shpreh se: *“Prokuroria ushtron ndjekjen penale....”*

<sup>8</sup> “Shpifja”.

<sup>9</sup> “Falsifikimi i dokumenteve”.



Neni 248<sup>10</sup>, i po këtij Kodi, përcakton se: *“Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet”.*

Neni 250<sup>11</sup> i Kodit Penal, sanksionon se: *“Kryerja e veprimeve ose dhënia e urdhrave arbitrare, nga ana e punonjësit që kryen një funksion shtetëror ose një shërbim publik gjatë ushtrimit të detyrës së tij, të cilat prekin lirinë e shtetasve, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet”.*

Neni 253<sup>12</sup>, i po këtij Kodi, përcakton se: *“Kryerja për shkak të detyrës e në ushtrim të saj, nga ana e punonjësit me funksion shtetëror apo në shërbim publik, të dallimeve mbi bazë origjine, seksi, orientimi seksual ose identiteti gjinor, gjendjes shëndetësore, bindjeve fetare, politike, të veprimtarisë sindikale ose për shkak të përkatësisë në një etni, komb, racë apo fe të caktuar, që konsiston në krijimin e privilegjeve të padrejta ose në refuzimin e një të drejte ose përfitimi që buron nga ligji, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet”.*

Kodi i Procedurës Penale, në nenet 277 e 278 të tij, ka parashikuar organet kompetente që ushtrojnë ndjekjen penale dhe që shprehen e disponojnë lidhur me të, shprehimisht: *“Prokurori dhe policia gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale.*

*Prokurori drejton hetimet dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore.*

*Gjatë hetimeve paraprake, për rastet e parashikuara nga ligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, viktimës dhe palëve private, vendos gjykata.*

*Kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, sipas paragrafit 1 të këtij neni, shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar”.*

Komisioneri informon ankuesin se, ankimimi kundrejt veprimeve apo mosveprimit të organeve shtetërore të tilla si Zyra Përmbartimore Shtetërore, në rastin konkret, bëhet pranë organeve kompetente të drejtësisë si, Prokuroria apo Gjykata, dhe shqyrtimi i tyre është jashtë kompetencave të KMD-së.

---

<sup>10</sup> *“Shpërdorim i detyrës”.*

<sup>11</sup> *“Kryerja e veprimeve arbitrare”.*

<sup>12</sup> *“Shkelja e barazisë së shtetasve”.*

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim e çështjeve që janë kompetencë e organeve si prokuroria e gjykata, bazuar në pretendime që lidhen me kundravajtje apo vepra penale të parashikuara në legjislacionin penal të Republikës së Shqipërisë<sup>13</sup>, apo për më tepër kontrolli i vendimmarrjeve të Prokurorisë, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj<sup>14</sup>.

Në nenin 33, pika 4/b, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) .....është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.”.

Lidhur me pretendimin e ankuesit, se është kanosur, kërcënuar dhe ushtruar presion ndaj tij nga punonjës të cilët ushtrojnë detyra shtetërore pranë Zyrës Përmbarimore Lezhë, Komisioneri informon subjektin ankues se, shqyrtimi i një fakti të tillë nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Neni 84<sup>15</sup> i Kodit Penal, sanksionon se: “Kanosja serioze për vrasje ose për plagosje të rëndë që i bëhet një personi, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit”.

Komisioneri i sugjeron subjektit ankues, se mund të ndjekë procedurën ligjore për kallëzim pranë organit të Prokurorisë, i cili në bazë të Kushtetutës dhe ligjit është organi kompetent që ushtron ndjekjen penale në Republikën e Shqipërisë.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/b të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ky kërkim i ankuesit nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e tij.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i rekomandon subjektit ankues, që, për problematikën e tij, t'i drejtohet për ofrimin e ndihmës ligjore falas, Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas,<sup>16</sup> ose Shërbimit Ligjor Falas<sup>17</sup>.

## **PËR KËTO ARSYE:**

---

<sup>13</sup> Falsifikimi i dokumentave, informacioni i rremë nga zyrtarë shtetërorë apo shpifja e kanosja, të pretenduara nga subjekti ankues.

<sup>14</sup> Për analogji citojmë Vendimin nr. 81, datë 26.04.2022, të KMD-së.

<sup>15</sup> “Kanosja”.

<sup>16</sup> Me adresë: Rruga "Jordan Misja" Godina nr. 3, Tiranë.

<sup>17</sup> Me adresë: Bulevardi: “Bajram Curri”, Pall: “Agimi”, Shk. 18, Ap. 322, Tiranë, Nr. tel: 0422 53113.

Mbështetur në nenin 20/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues B. Z, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Fusha: Të mira dhe shërbime  
Shkaku: Gjinia, bindja fetare, çdo shkak tjetër  
Lloji i vendimit: Mospranim